

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
NJOFTIM FITUESI

Date: 7 Tetor 2019

Për: Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Praslin Investment” sh.p.k. / NUIS K52113007F dhe “R&T” sh.p.k. / NUIS J61901094G, me adresë: Rruga “Nikolla Tupe”, Pallati 5/9, Tiranë.

Procedura konkurruese: Dhënia me koncesion/partneritet publik privat të portit të jahteve “Marina Rodon”, propozim i kërkuar.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Projektim, financim, ndërtim, vënien në operim, administrim dhe mirëmbajtjen e portit të jahteve “Marina Rodon” me vendndodhje në vijën bregdetare jugore të Gjirit të Drinit, rreth 7 km larg Kepit të Rodonit. Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit/PPP: 35 vjet

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 32 datë 13.8.2019

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në procedurë ky ofertues me ofertën përkatëse të ofruar:

- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Praslin Investment” sh.p.k. / NUIS K52113007F dhe “R&T” sh.p.k. / NUIS J61901094G, me vlerë investimi prej 883,461,666 Lekë, pa TVSH;

Është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

2. Nuk është skualifikuar asnjë ofertues

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Praslin Investment” sh.p.k. / NUIS K52113007F dhe “R&T” sh.p.k. / NUIS J61901094G, me adresë: Rruga “Nikolla Tupe”, Pallati 5/9, Tiranë, se oferta e paraqitur më datë 6 Shtator 2019, për marrjen me koncesion/PPP të portit të jahteve “Marina Rodon”, është pranuar.

Afati i negocimit të Kontratës tuaj do të jetë 60 ditë nga marrja e njoftimit të fituesit. Bashkimi Përkohshëm i Shoqërive “Praslin Investment” sh.p.k. / NUIS K52113007F dhe “R&T” sh.p.k. / NUIS J61901094G kërkohet t’i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare/Partneritetit Publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentat e Procedurës Konkurruese, në vlerën e 10% të Investimit (pa TVSH). Sigurimi duhet të paraqitet jo më vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- Ofertën origjinale e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokurë) duhet të nënshkruajë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike.
- Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.9.2019

Ankesa: Nuk ka